

L I G J
Nr.8545, datë 4.11.1999

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË DHE TË PROJEKTIT
NDËRMJET KFW-SË, REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOORPORATËS
ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI
ELEKTRIKE NË JUG TË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë dhe e Projektit ndërmjet KFW-së, Republikës së Shqipërisë dhe Koorporatës Elektroenergjitike Shqiptare për furnizimin me energji elektrike në jug të Shqipërisë”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.2483, datë 9.11.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

**MARRËVESHJA E HUASË DHE E PROJEKTIT NDËRMJET KFW-SË, REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE KOORPORATËS ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE PËR
FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE NË JUG TË SHQIPËRISË**

Në bazë të një marrëveshjeje, deri sa të përfundohet ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale Gjermane dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, në bashkëpunim financiar (“Marrëveshje qeveritare”), Huamarrësi, Agjencia e Ekzekutimit të Projektit dhe KfW hyjnë në huanë e mëposhtme dhe Projektmarrëveshjen:

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i Huasë

1.1.KfW do t’i lëvrojë Huamarrësit një Hua që nuk kalon 35.000.000 DM.

1.2.Huamarrësi do ta kanalizojë huanë totalisht për Agjencinë e Ekzekutimit të Projektit në përputhje me kushtet formuluar në Nenin 2. Agjencia e Ekzekutimit të Projektligjit do ta përdorë huanë ekskluzivisht për shpërndarjen e energjisë në Jug të Shqipërisë (“Projekti”) dhe fillimisht do të paguaj shpenzimet e këmbimit. Agjencia e Ekzekutimit të Projektit dhe KfW do të përcaktojnë detajet e Projektit dhe mallrat dhe shërbimet për t’u financuar nga huaja nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë.

1.3.Taksat dhe detyrime të tjera publike që duhet të shlyhen nga Huamarrësi ose Agjencia

e Ekzekutimit të Projektit, si dhe detyrime të tjera importi nuk do të financohen nga Huaja.

Neni 2

Kanalizimi i Huasë për Agjencinë e Ekzekutimit të Projektit

2.1. Huamarrësi do ta kanalizojë Huanë për Agjencinë e Ekzekutimit të Projektit sipas një marrëveshjeje huaje të veçantë sipas termave dhe kushteve formuluar në nenin 4.2 dhe 4.4 si më poshtë.

2.2. Përpara disbursimit të parë të Huasë, Huamarrësi do të dërgojë në KfW një përkthim të certifikuar të huamarrëveshjes specifikuar në nenin 2.1.

2.3. Kanalizimi i huasë nuk kushtëzon ndonjë detyrim të Agjencisë së Ekzekutimit të Projektit për KfW për pagesën e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Disbursimi

3.1. KfW do të disbursojë Huanë në përputhje me zhvillimin e Projektit dhe sipas kërkesave të Agjencisë së Ekzekutimit të Projektit. Me një marrëveshjeje të veçantë, Agjencia e Ekzekutimit të Projektit dhe KfW do të jetë dakord me procedurat e disbursimit, në mënyrë të veçantë në evidencën që provon që shumat e huasë së kërkuar janë përdorur për të stimuluar qëllimin.

3.2. KfW ka të drejtë të refuzojë bërjen e disbursimeve pas 31 dhjetorit 2006.

Neni 4

Tarifa e angazhimit, interesat dhe kthimi i borxhit

4.1. Huamarrësi do të paguajë një tarifë angazhimi prej $\frac{1}{4}$ % p.a. për shumat e huasë së padisbursuar. Tarifa e angazhimit është llogaritur për një periudhë që fillon tre muaj pas firmosjes së kësaj Marrëveshjeje dhe përfundon në datën në të cilën disbursimet janë paguar.

4.2. Huamarrësi do të paguajë një interes për huanë prej 0,75% p.a.. Interesi do të ngarkohet nga data në të cilën disbursimet janë paguar në datën në të cilën shlyerjet e borxhit janë kredituar në llogaritë e KfW specifikuar në nenin 4.9.

4.3. Huamarrësi do të paguajë një tarifë angazhimi, interes dhe ndonjë interes tjetër në fushat përcaktuar në nenin 4.5 çdo gjashtëmuajor në 30 qershor dhe në 30 dhjetor në fund të gjashtëmuajorit. Tarifa e parë e angazhimit do të paguhet së bashku me pagesën e interesit të parë.

4.4. Huamarrësi do të paguajë huanë si më poshtë:

Datat e Këstit		Shuma
1. 30 qershor	2009	573.000.00 DM
2. 30 dhjetor	2009	573.000.00 DM
3. 30 qershor	2010	573.000.00 DM
4. 30 dhjetor	2010	573.000.00 DM
5. 30 qershor	2011	573.000.00 DM
6. 30 dhjetor	2011	573.000.00 DM
7. 30 qershor	2012	573.000.00 DM
8. 30 dhjetor	2012	573.000.00 DM
9. 30 qershor	2013	573.000.00 DM
10. 30 dhjetor	2013	573.000.00 DM
11. 30 qershor	2014	573.000.00 DM
12. 30 dhjetor	2014	573.000.00 DM
13. 30 qershor	2015	573.000.00 DM

14. 30 dhjetor	2015	573.000.00 DM
15. 30 qershor	2016	574.000.00 DM
16. 30 dhjetor	2016	574.000.00 DM
17. 30 qershor	2017	574.000.00 DM
18. 30 dhjetor	2017	574.000.00 DM
19. 30 qershor	2018	574.000.00 DM
20. 30 dhjetor	2018	574.000.00 DM
21. 30 qershor	2019	574.000.00 DM
22. 30 dhjetor	2019	574.000.00 DM
23. 30 qershor	2020	574.000.00 DM
24. 30 dhjetor	2020	574.000.00 DM
25. 30 qershor	2021	574.000.00 DM
26. 30 dhjetor	2021	574.000.00 DM
27. 30 qershor	2022	574.000.00 DM
28. 30 dhjetor	2022	574.000.00 DM
29. 30 qershor	2023	574.000.00 DM
30. 30 dhjetor	2023	574.000.00 DM
31. 30 qershor	2024	574.000.00 DM
32. 30 dhjetor	2024	574.000.00 DM
33. 30 qershor	2025	574.000.00 DM
34. 30 dhjetor	2025	574.000.00 DM
35. 30 qershor	2026	574.000.00 DM
36. 30 dhjetor	2026	574.000.00 DM
37. 30 qershor	2027	574.000.00 DM
38. 30 dhjetor	2027	574.000.00 DM
39. 30 qershor	2028	574.000.00 DM
40. 30 dhjetor	2028	574.000.00 DM
41. 30 qershor	2029	574.000.00 DM
42. 30 dhjetor	2029	574.000.00 DM
43. 30 qershor	2030	574.000.00 DM
44. 30 dhjetor	2030	574.000.00 DM
45. 30 qershor	2031	574.000.00 DM
46. 30 dhjetor	2031	574.000.00 DM
47. 30 qershor	2032	574.000.00 DM
48. 30 dhjetor	2032	574.000.00 DM
49. 30 qershor	2033	574.000.00 DM
50. 30 dhjetor	2033	574.000.00 DM
51. 30 qershor	2034	574.000.00 DM
52. 30 dhjetor	2034	574.000.00 DM
53. 30 qershor	2035	574.000.00 DM
54. 30 dhjetor	2035	574.000.00 DM
55. 30 qershor	2036	574.000.00 DM
56. 30 dhjetor	2036	574.000.00 DM
57. 30 qershor	2037	574.000.00 DM
58. 30 dhjetor	2037	574.000.00 DM
59. 30 qershor	2038	574.000.00 DM
60. 30 dhjetor	2038	574.000.00 DM
61. 30 qershor	2039	574.000.00 DM

TOTALI

35.000,000.00 DM

4.5. Në qoftë se ndonjë nga këstet e borxhit nuk është në dispozicion të KfW kur duhet, KfW mund të rrisë përqindjen e interesit bazë plus 3% p.a. për fillimin e periudhës në datën e duhur dhe të fundit në datën në të cilën shlyerja e borxhit është kredituar në llogarinë e KfW, specifikuar në nenin 4.9. “Kursi Bazë” është përqindja e interesit mbyllur në Deutsche Bundensbank si interes bazë për interesin e aplikuar në datën përkatëse. Në rast të rritjes së interesave KfW duhet të pretendojë për dëmshpërblime. Këto dëmshpërblime nuk duhet të kalojnë shumën e arritur nëse interesat janë tarifuar në fusha të tilla interesash me bazë interesin mbizotërues në datën e shlyerjes plus 3% p.a.

4.6. Tarifa e angazhimit, interesat dhe ndonjë tarifë mbi ato të përcaktuara në nenin 4.5. do të llogaritet për 360 ditë të vitit dhe 30 ditë mujore.

4.7. Mosdisbursimet ose pagesat e parakohshme të huasë do të kreditohen në proporcione të barabarta kundrejt gjithë kësteve më të vogla të pagesës KfW, veçanërisht në rastet e shumave më të vogla.

4.8. KfW do të titullojë këtë kreditim si pagesa marrë kundrejt pagesave paguar sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas marrëveshjes së huasë, konkluduar midis KfW dhe Huamarrësit.

4.9. Huamarrësi duhet të shlyejë të gjitha pagesat në monedhën e Republikës Federale Gjermane në llogarinë e KfW me nr.22.3954.7450 në Kreditanstalt für Wiederaufbau, Frankfurt am Main (BLZ 500 204 00, S.W.I.F.T: KFWIDEFF).

Neni 5

Ndërprerja e disbursimeve dhe pagesat e parakohshme

5.1. Huamarrësi mundet në çdo kohë

a) të jetë subjekt i përmbushjes së kushteve sipas nenit 8, të anullojë ndonjë shumë huaje të padisbursuar akoma, dhe

b) të ripaguajë huanë tërësisht ose pjesërisht nëse paguhet më parë.

5.5. KfW mund të ndërpresë disbursimet të paktën kur:

a) Huamarrësi ka falimentuar në përmbushjen e detyrimeve ndaj KfW duke bërë pagesat kur duhen;

b) kushtet sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas marrëveshjes së veçantë përcaktuar në këtë marrëveshje nuk janë respektuar;

c) Agjencia e Ekzekutimit të Projektit nuk është në gjendje të provojë që shumat e huasë janë përdorur për të stimuluar qëllimin; ose

d) rrethana të jashtëzakonshme të krijuara e bëjnë të pamundur ose rrezikojnë zhvillimin, operacionin, qëllimin e Projektit ose kryerjen e pagesave marrë nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje.

5.3. Nëse ndonjë nga situatat, përcaktuar në nenin 5.2 a,b, ose c ka ndodhur ose nuk është eliminuar në një periudhë kohore të përcaktuar nga KfW, e cila nuk duhet të jetë më shumë se 30 ditë, KfW mund:

a) në rastet specifikuar në nenin 5.2. a) ose b) kërkon pagesa të menjëherëshme të të gjithë shumave të huasë sa pagesat e të gjithë interesave të rrjedhura dhe të gjithë tarifave të tjera;

b) në rastet specifikuar në nenin 5.2 c) kërkon pagesa të menjëherëshme të tilla që shumat e huasë aq sa Agjencia e Ekzekutimit të Projektit nuk është në gjendje të provojë që është përdorur për qëllimin e caktuar.

Neni 6

Kosto dhe Tarifat Publike

6.1. Huamarrësi do të bëjë të gjithë pagesat e bëra efektive sipas kësaj Marrëveshjeje pa ndonjë zbritje të taksave, tarifave të tjera publike ose kostove të tjera dhe duhet të paguajë kosto transferimi dhe konvertimi në lidhje me disbursimin e huasë.

6.2. Huamarrësi duhet të mbajë të gjithë taksat dhe tarifatat e tjera publike të rrjedhura jashtë Republikës Federale Gjermane në lidhje me përfundimin dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Vlefshmëria e huasë dhe projekt marrëveshjes dhe fuqia e prezantimit

7.1. Përpara disbursimit të parë, Huamarrësi duhet të paraqesë para KfW një evidencë që të provojë se Huamarrësi ka bërë të gjitha kërkesat sipas gjithë ligjeve për të gjithë kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

7.2. Ministri i Financës ose çdo person i adresuar prej tij ose saj tek KfW dhe i autorizuar me specimen firmosur autentikisht prej tij ose saj mund të përfaqësojë Huamarrësin për ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Drejtori i Përgjithshëm i KESH-it ose çdo person i adresuar prej tij ose saj tek KfW dhe i autorizuar me specimen firmosur autentikisht prej tij ose saj mund të përfaqësojë Agjencinë e Ekzekutimit të Projektit në ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje.

7.3. Amendamentet ose ndonjë shtesë, lidhur me këtë Marrëveshje bërë nga Palët kontraktuese duhet të bëhet me shkrim. Ndonjë shënim tjetër duhet të dërgohet në adresën e mëposhtme:

Për KfW: Kreditanstalt für Wiederaufbau
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Republika Federale Gjermane
Telefax: (0049-69) 74 31 – 29 44
Telex: 4 15 25 60 kw d
Për Huamarrësin: Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë, Shqipëri
Tel: (00355-42) 28 494
Telex: 0604 5295 komplab

Për Agjencinë e Ekzekutimit të Projektit: Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH)
Blloku “Vasil Shanto”
Tiranë, Shqipëri
Tel: (00355-42) 320 46

7.4. Amendamentet për këtë Marrëveshje hartuar midis KfW dhe Huamarrësit nuk kërkojnë aprovimin e Agjencisë së Ekzekutimit të Projektit.

Neni 8

Projekti

8.1 Agjencia e Ekzekutimit të Projektit duhet:

a) të përgatisë, të zhvillojë, të operojë dhe të ruajë Projektin, bazuar në praktikatat ekonomike dhe inxhinierike dhe në përputhje me konceptimin e Projektit, për të cilin është rënë dakord ndërmjet Agjencisë së Ekzekutimit të Projektit dhe KfW;

b) të caktojë përgatitjen dhe supervizimin e konstruksionit të Projektit nga inxhinierë të pavarur, të kualifikuar dhe zhvillimin e Projektit nga firma të kualifikuara;

c) të dekorojë kontraktuesit për punët dhe shërbimet për t’u financuar nga Huaja sipas kërkesave të krahasueshme ndërkombëtare;

d) të ruajë librat dhe regjistrat që tregojnë të gjitha shpenzimet për punët dhe shërbimet

kërkuar nga Projekti dhe identifikimin e qartë të mallrave dhe shërbimeve financuar nga huaja;

e) t'u japë mundësi përfaqësuesve të KfW në çdo kohë të inspektojnë librat dhe regjistrat, si dhe të gjithë dokumentacionin tjetër lidhur me Projektin dhe të vizitojnë Projektin dhe të gjitha instalimet e tjera lidhur me të;

f) të furnizojë KfW me informacione dhe raporte për Projektin dhe zhvillimin e tij siç i kërkon ajo.

8.2. Agjencia e Ekzekutimit të Projektit dhe KfW do të formulojë detajet e nenit 8.1 në një marrëveshjeje të veçantë.

8.3 Huamarrësi dhe Agjencia e Ekzekutimit të Projektit duhet:

a) të sigurojë financimin e plotë të Projektit për më tepër të kërkojnë që KfW shpenzimet e papaguara të kësaj huaje të mbulohen dhe

b) për veten e tyre t'i japin informacion të menjëhershëm KfW për një ose për të gjitha rrethanat që vënë në rrezik serioz zhvillimin e operacioneve të realizimit të Projektit.

8.4. Huamarrësi duhet t'i asistojë Agjencisë së Ekzekutimit të projektit në përputhje me praktikën inxhinierike dhe financiare në zhvillimin e Projektit dhe është i detyruar të ekzekutojë obligimet e Agjencisë së Ekzekutimit dhe Projektit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe në veçanti, t'i lejojë Agjencisë së Ekzekutimit të Projektit të gjithë hapësirën e nevojshme për zhvillimin e Projektit.

8.5. Për transportimin e mallrave financuar nga Huaja duhet të aplikohen furnizimet nga Marrëveshja Qeveritare, të cilat janë të njohura nga Huamarrësi.

Neni 9 Parashikime të tjera

9.1. Nëse ndonjë parashikim i kësaj Marrëveshjeje është i pavlefshëm, gjithë provizionet e tjera duhet të mbeten të painfluencueshme. Ndonjë boshllëk i rezultuar duhet të plotësohet (mbushet) nga një parashikim konsistent si qëllim i kësaj Marrëveshjeje.

9.2. Huamarrësi dhe Agjencia e Ekzekutimit të Projektit nuk mund të emërojnë ose transferojnë, ose lënë peng ndonjë pretendim nga kjo Marrëveshje.

9.3. Kjo Marrëveshje do të drejtohet nga ligji i Republikës Federale Gjermane. Vendi i kryerjes do të jetë Frankfurt am Main. Në rast të ndonjë paqartësie në interpretim të kësaj Marrëveshjeje, ekziston një tekst në gjermanisht.

9.4. Të gjitha paqartësitë e rrjedhura nga kjo Marrëveshje dhe të gjithë paqartësitë mbi vlefshmërinë e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të Marrëveshjes së Arbitrazhit, që nuk mund të zgjidhen miqësisht ndërmjet Palëve, do të zgjidhen nëpërmjet procedurave të arbitrazhit në përputhje me Marrëveshjen e Arbitrazhit si formë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

9.5. Kjo Marrëveshje nuk hyn në fuqi derisa Marrëveshja Qeveritare në të cilën është bazuar nuk ka hyrë në fuqi.

Hartuar në 6 kopje origjinale, 3 në gjermanisht, 3 në anglisht.

Frankfurt am Main,
KREDITANSTALT FÜR
WIEDERAUFBAU

Tirana
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Përfaqësuar
MINISTRIA E FINANCAVE

MARRËVESHJA

E ARBITRAZHIT ME REFERENCA TË NENIT 9.4 TË HUASË DHE MARRËVESHJES
NDËRMJET KREDITANSTALT FÜR WIEDERAUFBAU, FRANKFURT AM MAIN
("KFW") DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ("HUAMARRËSI") PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCAVE, SI DHE KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE

("AGJENCIA E EKZEKUTIMIT TË PROJEKTIT")

Furnizimi me energji në Jug të Shqipërisë KfW,
Huamarrësi dhe Agjencia e Ekzekutimit të Projektit janë dakord si më poshtë:

Neni 1

Të gjitha debatet nga Huaja dhe Projektmarrëveshja dhe debatet mbi vlefshmërinë e huasë dhe të projekt marrëveshjes, si dhe Marrëveshja e Arbitrazhit, të cilat nuk mund të zgjidhen miqësisht midis Palëve kontraktuese, përfundimisht do të zgjidhen nga Gjykata e Arbitrazhit.

Neni 2

Palët që do të procedojnë në arbitrazh do të jenë Huamarrësi dhe Agjencia e Ekzekutimit të Projektit nga njëra anë dhe KfW nga ana tjetër. KfW ka të drejtë të ngrejë padi kundrejt Huamarrësit dhe Agjencisë së Ekzekutimit të Projektit të ndarë ose bashkarisht. Gjithashtu, Huamarrësi dhe Agjencia e Ekzekutimit të Projektit ka të drejtë të ngrejë padi kundrejt KfW.

Neni 3

3.1. Gjykata e Arbitrazhit përbëhet nga tre arbitra si më poshtë:

Një arbitër caktohet nga Huamarrësi vetë ose, Në qoftë se Huamarrësi nuk ndërhyr ose nuk ka intervenuar në procedurë, nga Agjencia e Ekzekutimit të Projektit; një arbitër i dytë nga KfW, dhe një arbitër i tretë ("Drejtuesi") do të caktohet me pëlqimin e Palëve ose, Në qoftë se nuk bien dakord deri 60 ditë pas marrjes së kërkesës për arbitrazh nga mbrojtësi, me aplikimin e njëres Palë nga Presidenti i Dhomës së Tregtisë ose me falimentimin e takimit me të, nga Shefi i Komitetit Nacional të Zvicrës së Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Nëse njëra Palë falimenton në caktimin e arbitrit, ky arbitër do të caktohet nga Drejtuesi.

3.2. Në rast se arbitri i caktuar jep dorëheqjen ose nuk është më në gjendje të kryejë arbitrazhin, zëvendësuesi i tij do të caktohet në të njëjtën mënyrë si më sipër dhe ky i fundit do të ketë të gjitha kompetencat dhe detyrat e të parit.

Neni 4

4.1. Procedurat e arbitrazhit do të fillojnë nëpërmjet dorëzimit të një kërkesë të shkruar nga njëra Palë tjetrës. Kjo kërkesë do të pohojë natyrën e pretendimit, kompensimit që kërkohet dhe emrin e arbitrit të emëruar nga kërkesuesi me kusht që kërkesuesi të autorizohet të emërojë një arbitër në bazë të nenit 3.1 të Marrëveshjes.

4.2. Brenda 30 ditëve me marrjen e një deklarate të tillë, i padituri do të lajmërojë kërkesuesin për emrin e arbitrit të emëruar nga ai, me kusht që i padituri të jetë i autorizuar të emërojë një arbitër në bazë të nenit 3.1 të marrëveshjes.

Neni 5

Arbitrazhi do të mbledhet në kohën që caktohet nga Kryetari. Përveç kur Palët kanë rënë dakord për vendin e procedurave të arbitrazhit, ky vend gjithashtu do të caktohet nga Kryetari.

Neni 6

Arbitrazhi do të vendosë me kompetencën e tij. Ai do të vendosë procedurat në lidhje me rregullat e njohura të procedurës. Në çdo rast Palëve do t'u akordohet një seancë gojore.

Arbitrazhi mund të arrijë në një vendim pavarësisht nga mungesa e njëres Palë. Të gjitha vendimet e arbitrazhit do të bëhen me miratimin e të paktën 2 arbitrave.

Neni 7

Arbitrazhi do ta japë vendimin me shkrim. Një vendim i nënshkruar nga të paktën 2 arbitra do të përbëjë një vendim të Arbitrazhit. Secila Palë do të marrë një origjinal të vendimit. Vendimi do të jetë i detyrueshëm dhe final. Duke nënshkruar këtë Marrëveshje të dyja Palët marrin përsipër detyrimin për t'iu përmbajtur vendimit.

Neni 8

8.1. Palët do të bien dakord për pagesën e arbitruessve dhe të personave të tjerë, që do të kryejnë procedura arbitrimi.

8.2. Në se Palët bien dakord para ndërhyrjes së Gjykatës së Arbitrazhit, Gjykata e Arbitrazhit duhet të fiksojë pagesën përkatëse. Secila Palë do të heqë shpenzimet e saj për procedurat e arbitrimin. Koston e Gjykatës së Arbitrazhit duhet t'i heqin të dy Palët proporcionalisht.

8.3 Gjykata e Arbitrazhit definitivisht do të vendosë për të gjithë çështjet, kostot përkatëse.

8.4 Palët duhet të paguajnë detyrimet për pagesat e shpërblimeve të personave të specifikuar në nenin 8.1.

Neni 9

Çdo vërejtje e Palëve për procedurat e arbitrimin duhet të paraqitet me shkrim. Këto vërejtje duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme:

Për KfW:

Kreditanstalt für Wiederaufbau
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Republika Federale Gjermane
Telefax: (0049-69) 74 31 – 29 44
Telex: 4 15 25 60 kw d

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tirana, Shqipëri
Tel. (00355 – 42) 28 494
Telex: 0604 52 95 komplab

Për Agjencinë e
Ekzekutimit të Projektit

Korporata elektroenergjitike
Shqiptare
Blloku “Vasil Shanto”
Tirana, Shqipëri